LIGJ
Nr.10 189, datë 12.11.2009

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT PËR IMUNITETET DHE PRIVILEGJET E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli për imunitetet dhe privilegjet e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6350, datë 24.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLL
LIDHUR ME PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E ASAMBLESË PARLAMENTARE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI

Shtetet anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi: Republika e Shqipërisë, Republika e Armenisë, Republika e Azerbajxhanit, Republika e Bullgarisë, Gjeorgjia, Republika e Greqisë, Republika e Moldavisë, Rumania, Federata Ruse, Republika e Turqisë dhe Ukraina;

meqenëse neni 20 i Kartës së Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi parashikon se Asambleja Parlamentare e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, si përfaqësuese e parlamenteve të shteteve anëtare, siguron mbështetje të përhershme për procesin e bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi mbi bazë konsultimesh, meqenëse APBEDZ-ja bashkëpunon ngushtë me BEDZ-in në nxitjen e objektivave të këtij të fundit, mbështetur në parimet e "Deklaratës së Samitit mbi Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi", Stamboll, 25 qershor 1992, në vendimet e takimeve

vijuese të samitit dhe "Deklaratën mbi krijimin e Asamblesë Parlamentare të Bashkëpunimit të Detit të Zi", miratuar më 26 shkurt 1993 në Stamboll;

duke marrë parasysh rolin që mund të luajë Asambleja Parlamentare e BEDZ-it në mobilizimin e mbështetjes publike në organizimin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit, në nxitjen e stabilitetit dhe paqes në rajon dhe në lehtësimin e realizimit të parimeve dhe synimeve të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi;

të bindur se përfundimi i Protokollit mbi privilegjet dhe imunitetet e Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi do të lehtësojë funksionet e Asamblesë në përputhje me parimet dhe objektivat e BEDZ-it,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllime të këtij protokolli:

a) "Kartë" do të thotë Karta e Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi", bërë në Jaltë, më 5 qershor 1998.

b) "Këshilli" do të thotë Këshilli i Ministrave të Punëve të Jashtme të Organizatës së Bashkëpunimit të Detit të Zi.

c) "Shtete anëtare" do të thotë shtete që janë palë në Kartën e BEDZ-it, bërë në Jaltë, më 5 qershor 1998 dhe palë në këtë protokoll.

d) "APBEDZ" do të thotë Asambleja Parlamentare e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi.

e) "Përfaqësues të parlamenteve të shteteve anëtare" do të thotë anëtarë të delegacioneve kombëtare, të caktuar nga parlamentet e vendeve përkatëse dhe delegatë plotësues, këshilltarë, ekspertë teknikë dhe sekretarë të delegacioneve kombëtare që marrin pjesë në punimet e APBEDZ-it dhe organeve të tij.

f) "BSEC PERMIS" do të thotë Sekretariati i Përhershëm Ndërkombëtar i Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi.

g) "Stafi i Sekretariatit Ndërkombëtar" do të thotë stafi drejtues, stafi profesionist dhe stafi teknik i Sekretariatit të Përhershëm të APBEDZ-it.

h) "Prona e APBEDZ-it" do të thotë të gjitha pronat, duke përfshirë fondet dhe pasuri të tjera që u përkasin, zotërohen dhe/ose mbikëqyren nga APBEDZ-i, në përputhje me detyrat e tij zyrtare.

i) "Godina" do të thotë godina ose pjesë të tyre, duke përfshirë dhe truallin pranë tyre, që përdoren vetëm për qëllimet e APBEDZ-it, pavarësisht nga pronësia.

j) "Arkivat" do të thotë të dhënat e regjistruara, korrespondenca, dokumentet, evidencat kontabile dhe të gjitha dokumentet e tjera financiare, dorëshkrimet, piktura dhe filma me xhirim të shpejtë dhe fikse, regjistrime zanore, programe kompjuterike, materiale të shkruara, videoregjistrues ose disqe, disqe ose regjistrues me të dhëna që i përkasin ose që mbahen nga APBEDZ-i.

KREU II
PRONAT

Neni 2

APBEDZ, pronat dhe pasuritë e saj, kudo që të ndodhen dhe kushdo qoftë mbajtësi i tyre, gëzojnë imunitet ndaj çdo forme procesesh ligjore, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë, kur Këshilli, me vendim të tij, autorizon heqjen e këtij imuniteti. Sidoqoftë, ekziston mirëkuptimi se heqja e këtij imuniteti nuk do të shtrihet deri në masën e ekzekutimit ose ndalimit të pronësisë.

Neni 3

Godinat e APBEDZ-it janë të pacenueshme.

Neni 4

Arkivat e APBEDZ-it dhe në përgjithësi të gjitha dokumentet që i përkasin ose janë në zotërim të saj janë të paprekshme kudo që ndodhen.

KREU III
PËRFAQËSUESIT E PARLAMENTEVE TË SHTETEVE ANËTARE

Neni 5

Përfaqësuesit e parlamenteve të shteteve anëtare, në kryerjen e funksioneve të tyre gjatë takimeve të APBEDZ-it dhe udhëtimeve të tyre për në dhe nga vendi ku zhvillohen këto takime, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e poshtëshënuara:

a) Imuniteti ndaj arrestimit ose ndalimit të personit, sekuestrimit të bagazheve vetjake dhe imuniteti ndaj proceseve ligjore të çdo lloji, lidhur me fjalët e thëna ose të shkruara dhe për të gjitha veprimet që ata kanë kryer në cilësinë e tyre si përfaqësues;

b) Paprekshmëria e të gjitha letrave dhe dokumenteve, duke përfshirë programet kompjuterike, videoregjistruesit ose disketa me të dhëna në zotërim të tyre;

c) Të drejtën për përdorimin e kodeve dhe marrjen e letrave ose korrespondencës nëpërmjet postës ose çantave me vulën e misioneve diplomatike të shteteve anëtare;

d) Përjashtimit për ta dhe bashkëshortët/bashkëshortet e tyre nga kufizimet e imigrimit, regjistrimi si të huaj ose detyrimet për shërbime kombëtare në shtetin anëtar të BEDZ-it ku ata ndodhen për vizitë ose përmes të cilit ata po kalojnë gjatë kryerjes së funksioneve të tyre;

e) Lidhur me çështjet doganore dhe kontrollit valutor:

- do t'u jepen nga qeveria e shtetit të tyre të njëjtat lehtësi si ato që u jepen zyrtarëve të lartë që udhëtojnë jashtë vendit me detyra zyrtare të përkohshme;
- do t'u jepen nga qeveritë e shteteve të tjera anëtare, të njëjtat lehtësi si ato që u jepen përfaqësuesve të qeverive të huaja që janë me detyra të përkohshme zyrtare.

Neni 6

Për t'iu garantuar përfaqësuesve të parlamenteve të shteteve anëtare lirinë e fjalës dhe pavarësinë në kryerjen e detyrave të tyre, ata do të vazhdojnë të kenë imunitet ndaj proceseve ligjore lidhur me fjalët e thëna ose të shkruara dhe për të gjitha veprimet e tjera të kryera gjatë përmbushjes së detyrave të tyre, pavarësisht se personat në fjalë nuk janë më të angazhuar në realizimin e këtyre detyrave.

Neni 7

Privilegjet dhe imunitetet për përfaqësuesit e parlamenteve të shteteve anëtare nuk jepen për përfitime vetjake të vetë individëve, por në funksion të garantimit të kryerjes së pavarur të funksioneve të tyre në APBEDZ. Rrjedhimisht, një shtet anëtar ka të drejtë t'i heqë imunitetin përfaqësuesit të parlamentit të tij në çdo rast kur, sipas mendimit të këtij shteti anëtar, imuniteti pengon procedimin nga drejtësia dhe kur ky imunitet mund të hiqet pa cenuar qëllimin për të cilin ai është dhënë.

Neni 8

Dispozitat e neneve 5, 6 dhe 7 nuk do të aplikohen në marrëdhëniet ndërmjet përfaqësuesit të parlamentit të një shteti anëtar dhe atij shteti.

KREU IV
STAFI I SEKRETARIATIT NDËRKOMBËTAR

Neni 9

Dispozitat e neneve 5, 6, 7 dhe 8 do të aplikohen për stafin e Sekretariatit Ndërkombëtar, gjatë kohës kur ata kryejnë funksionet e tyre gjatë takimeve të APBEDZ-it, si dhe udhëtimeve të tyre për në dhe nga vendet ku zhvillohen këto takime.

KREU V
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 10

Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet shteteve anëtare lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij protokolli do të jenë objekt konsultimesh dhe kur nuk arrihet asnjë marrëveshje, atëherë palët e interesuara do t'ia paraqesin këtë mosmarrëveshje Këshillit për shqyrtim dhe për veprime të duhura në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11

Në përputhje me nenin 20 të Kartës, asgjë në këtë protokoll nuk do të interpretohet, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, se do të ndryshojë statusin e APBEDZ-it, si një organizëm që ka lidhje me BEDZ-in.

Neni 12

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi.

2. Ky protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen në Sekretariatin e Përhershëm të BEDZ-it.

Neni 13

Asnjë rezervë nuk mund të bëhet ndaj këtij protokolli, me përjashtim të dispozitave të neneve 8 dhe 9.

Neni 14

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës kur nëntë shtetet nënshkruese do të depozitojnë instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

2. Për secilin shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë protokoll pas datës së hyrjes së tij në fuqi, ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën kur ai Shtet do të depozitojë instrumentet përkatëse të aderimit.

Neni 15

1. Çdo shtet anëtar mund të bëjë propozime për ndryshime ndaj këtij protokolli.

2. Teksti i çdo lloj ndryshimi të propozuar do të qarkullojë në shtetet anëtare të Organizatës nëpërmjet Sekretariatit të Përhershëm të BEDZ-it dhe do t'i paraqitet Këshillit për shqyrtim dhe miratim.

3. Ndryshimet në këtë protokoll, të miratuara sipas paragrafit 2 të sipërpërmendur, do të jenë objekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet anëtare dhe do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së parashikuar në nenin 14.

Neni 16

Kopja e vetme e origjinalit të këtij protokolli do të depozitohet te depozituesi.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit duke qenë të autorizuar sipas rregullit për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Baku, në ditën e tridhjetë e një të tetorit të vitit dy mijë e tre.

Për Republikën e Shqipërisë
Për Republikën e Armenisë
Për Republikën e Azerbajxhanit
Për Republikën e Bullgarisë
Për Gjeorgjinë
Për Republikën e Greqisë
Për Republikën e Moldavisë
Për Rumaninë
Për Federatën Ruse
Për Republikën e Turqisë
Për Ukrainën